



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Prill 2021

Nr:242

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E VËZHguesve TË KOALICIONIT PËR REFORMA DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA, SHOQATËS PËR INTEGRIM TË ZONAve INFORMALE, QENDRA PËR ZHVILLIMIN DHE DEMOKRATIZIMIN E INSTITUCIONEVE DHE FONDACIONIT “KUJTO” PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021.

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Të miratojë kërkesën e Koalicioni për Reforma dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) për akreditimin e 778 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë kërkesën e Shoqatës për Integrim të Zonave Informale (SHIZI) për akreditimin e 362 (treqind e gjashtëdhjetë e dy) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.



3. Të miratojë kërkesën e Qendrës për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve (QZHDI) për akreditimin e 24 (njëzet e katër) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë kërkesën e Fondacionit “KUJTO” për akreditimin e 143 (njëqind e dyzet e tre) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes 4 bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Iirjan CELIBASHI

